

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN, -Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi, me zyrteren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të akuzuarve E.K. nga ..., për shkak të dy veprave penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së dhe sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, si dhe H.B. nga ..., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH në Gjilan, PP.II.nr.1667/17 e dt.29.09.2017, të cilën epërfaqsonte prokurori i shtetit Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 14.02.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari **E.K.** nga i ati H. dhe nëna H. e lindur K. i lindur më datë ... në ... ku edhe jeton rruga “ ... ” nr. ..., I pamartuar, baba i dy fëmijëve, pronar i NT “ ... ”, ka kryer shkollën e mesme i gjendjes së mesme ekonomike , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës .

2. E akuzuara **H.B.** nga i ati N. dhe nëna B. e lindur, A. e lindur më datë ... në ..., tani jeton, në rr.” ... ” nr. ... e pamartuar, studente e kolegjit “ ... ”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase i Republikës së Kosovës.

**Janë fajtor
Sepse**

I

- I pandehuri **E.K.**:

-Më datë 29.12.2016, rreth orës 00:33 minuta, me qëllim të shkaktimit të frikës ose shkaktimit të ankthit, përmes SMS-ve, seriozisht ka kanosur të dëmtuarën H.B., në atë mënyrë që i pandehuri përmes SMS-ve i drejtohet me fjalët “**dil jasht, se të hi brenda, të kalli krejt, 20 sekonda i ki, nëse sdel vi brenda tmys**”, me çka tek e dëmtuara H. ka shkaktuar ankth, frikë dhe pasiguri për jetë.

-me çka ka kryer vepër penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i **KPRK-së.**

II

-Më datë 17.09.2017, në kohë të pa vërtetuar, në ..., i pandehuri E., ka sulmuar të dëmtuarën – të pandehurën H.B., në atë mënyrë që fillimisht kishin pasur mosmarrëveshje lidhur me pasëordat e telefonit, e më pastaj kishte ardhur edhe deri tek sulmi, me ç'rast në momentin që e dëmtuara tenton t'ia merr telefonin, i pandehuri përdor forcën dhe sulmon fizikisht tani të dëmtuarën H., duke e goditur me shuplakë.

-me çka ka kryer vepër penale , sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së.

III

E pandehura H.B.:

-Më datë, kohë dhe vend si në dispozitivin I (një) të aktakuzës, e pandehura e ka sulmuar të dëmtuarin - pandehurin E.K., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve që kishin pasur mes veti, e pandehura e përdor forcën dhe e sulmon të dëmtuarin E., me ç'rast i shkakton gërvishtje.

-me çka ka kryer vepër penale , sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 7,17,21,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 451 të KPPRK-së, iu shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit E.K. i shqipton për veprën e parë 180 ditë burgim si dhe për veprën e II-të 150 ditë burgim, e konform nenit 80 të KPRK-së atij ia shqipton një dënim unik prej 11 (njimbdhjetë) muajve si dhe H.B. gjykata ia shqipton dënimin prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve burgim, të cilat dënime dy të pandehurit nuk do ti mbajnë nëse në afat prej 1(një) viti pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale.

Obligohen të akuzuarit që ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumë secili prej nga 20 €, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur PP.II. nr.1667 të datës 29.09.2017 ndaj të akuzuarve, E.K. dhe H.B., për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-së dhe veprave penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 14.02.2018, prokurori Shefik Memeti, gjatë fjalës përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzës që ka të bëjë më të akuzuarit E.K. dhe H.B.

Të akuzuari E.K. dhe H.B., në fjalën e tyre përfundimtare pohojnë se ndjejnë veten fajtor, e kërkojnë nga gjykata që t'i dënojnë me një dënim sa më të butë, duke premtuar se një gjë të tillë më kurrë nuk do ta përsërisin.

Gjykata, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPPRK-së për pranimin e fajësisë, ngase të pandehurit i kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se të pandehurit E.K. nga ..., me dashje e ka kryer veprën penale kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK, dhe veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 i KPRK-së dhe H.B. me dashje ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 i KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i shpalli fajtor të pandehurit E.K. dhe H.B., nga ..., për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 dhe veprave penale sulmi nga neni 188 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën janë edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurve E.K. dhe H.B., nga ... gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë, se, ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj veprë, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurve, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Më 14.02.2018

Sekretarja juridike,
Florentina Ademi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*